

Nr. Prot. 004/B/18

VENDIM Nr. 1100

Për

Miratimin e “Rregullores për Pagesat Vjetore për Mbikëqyrje dhe të Drejtën e përdorimit të Radio Frekuencave”

Në mbështetje të nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 10, paragrafi 4) dhe 12), nenit 45 paragrafët 1) dhe paragrafi 2), nenit 54 paragrafi 2.6), nenit 57 paragrafi 1) dhe 2) dhe nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi, Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari, Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli, Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 25-të me radhë të mbajtur më datë: 16 Janar, 2018 pas shqyrtimit të raportit të komisionit, unanimisht vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet **“Rregullorja për Pagesat Vjetore për Mbikëqyrjen dhe të Drejtën e Përdorimit të Radio Frekuencave”**.
- II. Kjo Rregullore ka efekt juridik nga 1 Janar, 2018.
- III. Të gjitha faturat e lëshuara për shërbimet IMT gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2017 do të rishikohen, ashtu që për ditët e shfrytëzuara të radio frekuencave deri më 31 Dhjetor, 2017 do të aplikohen tarifat sipas Rregullorja nr. 17, për Pagesat për Shfrytëzimin e Radio Frekuencave , kurse për ditët e shfrytëzuara të radio frekuencave prej datës: 1 Janar, 2018 do të aplikohen tarifat sipas Rregullores së miratuar në paragrafin I të këtij vendimi.

- IV. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja Nr. 17, për Pagesat për Shfrytëzimin e Radio Frekuencave (*nr.prot. 082/B/11; dt. 20/12/12*).
- V. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Ligji, respektivisht neni 10 (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizon kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve dhe rregullimin e tregut të komunikimeve elektronike.

Neni 54 paragrafi 2.6 përcakton se Autoriteti vendos kushtet për pagesat për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio – frekuencave, si dhe pagesat tjera në buxhetin e shtetit.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i pagesave të rregullta vjetore për mbikëqyrje të shfrytëzimit të radio frekuencave dhe për të drejtën e përdorimit të radio frekuencave, si resurse të fundme kombëtare që menaxhohen nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje – ARKEP ose Autoritetit*) në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Kjo rregullore ka efekt retroaktiv nga data: 1 Janar, 2018 për shkak se pagesa që do të aplikohet për operatorët është pagesë vjetore.

ARKEP ka pranuar kërkesë nga operatori IPKO Telecommunications LLC me datë: 29 Dhjetor, 2017 dhe 19 Janar, 2018 për anulimin e faturës të datës: 27 Dhjetor, 2017, për shfrytëzim të brezit frekuencor 1800 MHz, ashtu që për ditët e shfrytëzuara gjatë vitit 2017, të llogaritet sipas Rregullores nr. 17, kurse për ditët vijuese sipas Rregullores, e cila do të miratohet nga ARKEP. Poashtu, me datë: 19 Janar, 2018 edhe Telekom i Kosovës Sh.A. ka deklaruar se përkrahë dhe ndanë të njëjtin qëndrim lidhur me çështjen e ngritur nga operatori IPKO.

Në bazë të Vendimit nr. 725 dhe Vendimit nr. 726, për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të Radio Spektrit Frekuencor në kuadër të brezit 1800 MHz për operatorët Telekom i Kosovës Sh.A. dhe IPKO Telecommunications LLC është përcaktuar se ky brezë do të jetë në dispozicion për shfrytëzim efektiv me fillim nga data: 06 Dhjetor, 2015. Atëherë, për ditët e shfrytëzuar gjatë datës: 06 Dhjetor, 2017 deri me 31 Dhjetor, 2017 do të aplikohen tarifat sipas Rregullores nr. 17, kurse prej datës: 1 Janar, 2018 do të aplikohen tarifat sipas Rregullores së miratuar në paragrafin I të këtij vendimi.

Kurse, sa i përket operatorit “mts” D.O.O., tarifa për shërbimet IMT për vitin 2017 do të llogaritet në përputhje me paragrafin III të Vendimit nr. 905, ashtu që deri me 31 Dhjetor, 2017 do të aplikohen tarifat sipas Rregullores nr. 17, kurse për ditët e shfrytëzuara të radio frekuencave nga

data: 1 Janar, 2018 do të aplikohen tarifat sipas Rregullores së miratuar në paragrafin I të këtij vendimi.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 19/01/2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

**Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit**

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve të rrjetit të komunikimeve elektronike
- Arkivës së Autoritetit